



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr. 24 Prot.

Tiranë, më 15.07.2011

UDHËZIM

Nr. 24 datë 15.07.2011

**PËR PROCEDURAT E BOTIMIT, SHTYPJES, SHPËRNDARJES DHE SHITJES
SË TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
NGA SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR**

Në zbatim të Vendimit nr. 107 datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave, për "Botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 27.01.1997, "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionin shkollor",

UDHËZOJ:

1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU), do të realizojë botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të sistemit parauniversitar, ku përfshihen tekstet për shkollat profesionale (teknike, social kulturore e të gjuhëve të huaja) si dhe tekstet e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase.
2. Në çdo vit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, (MASH) dërgon në SHBLU listën e teksteve të kërkuara për botim. Për secilin tekst dërgohen planet mësimore, tirazhet respektive dhe specifikime të tjera.
3. SHBLU-ja përllogarit koston paraprake, të cilën e dërgon në MASH, për të kërkuar miratimin e fondeve buxhetore të nevojshme.
4. Për secilin tekst të miratuar për botim, SHBLU-ja formon grupet e autorëve, komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve dhe organizon fillimin e procedurës së botimit.
5. SHBLU-ja, lidh kontrata paraprake bashkëpunimi me autorët e teksteve.
6. Për të garantuar cilësi të plotë të botimit, ajo zbaton me korrektësi të gjithë skemën teknologjike të përgatitjes së teksteve.
7. Vetëm pas miratimit të tekstit nga Këshilli botues i SHBLU-së, nënshkruhet kontrata me autorët dhe bëhet shpërblimi i autorësisë, sipas tarifave të VKM nr. 120, datë 27.01.1997, "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionin shkollor".

8. Në rastet e përshtatjes së teksteve të minoritetit grek dhe maqedonas nga versioni shqip, MASH siguron edhe lejen e botimit nga botuesi përkatës.
9. Kur tirazhi i teksteve të kërkuara për botim (ose procese të veçanta të tij) nuk realizohet me mundësitë dhe pajisjet teknologjike të SHBLU, ajo kooperon me shtëpi botuese apo shtypshkronja të tjera, duke zbatuar procedurat ligjore në fuqi.
10. SHBLU-ja, bën kolaudimin e produktit, nënshkruan lejen e qarkullimit, bën publicitetin e tekstit dhe dorëzon 5 kopjet të tij në Bibliotekën Kombëtare.
11. Çdo tekst pajiset me ISBN, dhe në kopertinën e tij vendoset çmimi i miratuar nga MASH si dhe pulla me hologramën, e cila sigurohet falas nga MASH.
12. SHBLU-ja, për të gjitha proceset që lidhen me autorësinë (përfshirë edhe ribotimin e ripunimin), parapërgatitjen, pjesëmarrjen në komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve, zbaton tarifat e shpërblimeve sipas VKM nr. 120, datë 27.01.1997, "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionin shkollor".
13. Shpërndarja dhe shitja e teksteve do të bëhet nga SHBLU-ja. Drejtoritë e shkollave do të lejojnë shitjen e teksteve në mjediset e tyre dhe sipas kushteve do të venë në dispozicion të SHBLU-së mjedise magazinuese për tekste.
14. Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave të SHBLU-së, dhe do të përdoren sipas VKM nr. 424, datë 09.07.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", pika 1/b, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nr. 33 datë 10.10.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore".
Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave në thesar të SHBLU-së, me adresë:

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR, Tiranë

Nr. llogarisë: 0104030780

IBAN Code: AL22202110130000000104030780

15. Në fund të çdo viti, SHBLU-ja, dërgon në MASH, raportin dhe analizën financiare për realizimin e botimeve.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi do të përballohen nga buxheti i planifikuar i MASH.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MYQEREM TAFAJ



MINISTËR